



**ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
"SKODRINON" SH.A.**

Nr. 333 prot,

Shkodër, me datë 29/05/2026

V E N D I M

Nr. 6, datë 29.05.2026

**PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË RI TË TARIFAVE PËR AKOMODIMIN E
PUSHUESVE NË STACIONET E PLAZHEVE PUBLIKE TË MENAXHUESHME
NGA SHOQËRIA AKSIONARE SKODRINON SH.A."**

Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë Aksionare "SKODRINON" sh.a., me aksionar të vetëm Bashkia Shkodër, e përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, në mbledhjen e datës 29.05.2026, me propozim të Këshillit të Administrimit të shoqërisë, në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, Ligjit nr. 9901, datë 14.8.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, neni 135 pikat 1, 2 si dhe pika 4, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.15, datë 20.7.2023 "Për krijimin e shoqërisë aksionare " BIO STRAJCA " sh.a., si person juridik në pronësi të Bashkisë Shkodër, miratimin e akt themelimit dhe statutit", në referim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 28, datë 29.05.2025 " Për dhënie pëlqimi, shtesa dhe ndryshime për shoqërinë aksionare " Bio Strajca" në pronësi të bashkisë Shkodër", Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", në kuadër të kompetencave të parashikuara në nenin 7, gërma c), të Statutit të kësaj shoqërie, si dhe në mbështetje të Vendimit nr.6, datë 11/05/2026 të Këshillit të Administrimit;

V E N D O S I:

1. **Miratimin e nivelit të ri të tarifave** për akomodimin e pushuesve në stacionet e plazheve publike në Velipojë dhe Rrjoll , të cilat janë të menaxhuara dhe administruara nga shoqëria ,si me poshtë :
 - 1.1 Tarifë ditore për 1 (një) set çadra dhe shezllone (2 krevate+ 1 çadër) = **400 (katërqind)** lekë, për stacionet e plazheve publike në Velipojë .
 - 1.2 Tarifë ditore për 1 (një) set çadra dhe shezllone (2 krevate+ 1 çadër)= **300 (treqind)** lekë për për stacionet e plazheve publike në Rrjoll.
2. Pika 2 e Vendimit Nr. 9, datë 20.06.2025 të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë , **shfuqizohet**
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe efektet financiare i fillojnë me datë 01.06.2026
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i shoqërisë.

PËR ASAMBLENË E PËRGJITHSHME

PËRFAQËSUAR

KRYETAR

BENEF BECI

